



BULETINI INFORMATIV

Janar - Mars 2024





Fjala Hyrëse e Kryetarit

Përshëndetje, dashamirë të basketbollit.



Me kënaqësi ju përshëndes në këtë numër të parë të Buletinit të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) për vitin 2024. Në këtë fazë të re të udhëtimit tonë sportiv, shikojmë pas të kaluarës së suksesshme me krenari dhe përgatitemi me zell për sfidat e ardhshme që na presin. Viti 2023 ishte një periudhë e mbushur me sfida dhe suksese të mëdha për basketbollin në vendin tonë. Mirëpo, ne e dimë që përpara nesh ka ende shumë punë dhe sfida të reja, dhe për këtë arsye ne kemi përgatitur një plan të shkëlqyer për t'i përballuar ato me sukses në vitin 2024.

Aktivitetet tona filluan menjëherë pas fillimit të vitit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë të rinjve dhe të rriturve në komunitetin tonë. Në këtë kohë, me gëzim shënojmë përfundimin e një çereku të vitit me arritje të shumta dhe kemi synime më të mëdha për të tjerët.

Në veçanti, me krenari e theksojmë se në verën e vitit 2024 do të organizojmë pesë ngjarje ndërkombëtare në Prishtinë, në bashkëpunim të ngushtë me FIBA-n dhe FIBA 3x3. Ky është një hap i rëndësishëm për ne, duke treguar përkushtimin tonë të vazhdueshëm për të avancuar basketbollin tonë dhe për të prezantuar talentin dhe potencialin tonë në skenën ndërkombëtare.

Duke e bërë këtë, ne e shohim këtë si një test për aftësitë tona, por edhe si një mundësi për tu rritur dhe për ti treguar botës se sa shumë mund të arrijmë.

Në fund, dua të shpreh mirënjohjen time të thellë për të gjithë ata që kanë kontribuar në basketbollin e Kosovës, nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport e Kosovës (MKRS) si mbështetësja më e madhe e sportit të basketbollit, klubet, lojtarët, trajnerët, sponsorët/partnerët, dhe të gjitha grupet e tjera të interesit.

Ju uroj sukses në vazhdim dhe shpresoj që të jetë një vit i shkëlqyeshëm për ne të gjithë.

Me respekt,
Arben FETAHU
Kryetar
Federata e Basketbollit e Kosovës

KOSOVA



Kosova fiton ndaj Irlandës dhe pëson nga Azerbajxhani

Kosova në shkurt për Parakualifikimet evropiane për Kupën e Botës 2027, zhvilloi dy ndeshje, duke shënuar një fitore dhe pësoi një humbje. Dardanët në palestrën e mbushur në Prishtinë, fituan ndaj Irlandës 83:76. Gjatë kësaj ndeshje u nderuan me mirënjohje tifozët Dardanët, si dhe ish-basketbollisti Alban Veseli.

Ndërkohë, Dardanët në Baku pësuan humbje nga Azerbajxhani 87:77. Sfidat e ardhshme do të jenë në nëntor si mysafir ndaj Zvicrës dhe Irlandës.



Mbahet Kuvendi i Punës i FBK-së

Federata e Basketbollit e Kosovës (më 13 mars) ka mbajtur Kuvendin e Punës. Në këtë Kuvend morën pjesë 25 delegatë nga 32. Fetahu ka prezantuar punën që është bërë nga Federata e Basketbollit e Kosovës në vitin 2023 dhe punën që e pret FBK-në në vitin 2024. Është bërë Aprovimi i Procesverbalit nga Kuvendi i kaluar i Punës, e më pas është prezantuar Raporti i Auditimit 2023, Draft Plani i Veprimit 2024, Draft Plani Financiar 2024, Draft Plani i Marketingut 2024, si dhe pika të ndryshme. Pas diskutimit të gjitha pikat janë miratuar.



Spektakli i Final 8 në Gjakovë

Nga 13 deri më 17 shkurt u zhvillua Final 8 i Kupës së Kosovës në Gjakovë, që ishte një spektakël i basketbollit, si në parket, ashtu edhe në tribuna.

E treta radhazi për Trepçën



Trepça është fituese e Kupës së Kosovës në basketboll. Mitrovicasit në një super finale dhe një super triler kanë mundur Sigal Prishtinën 71:69. MVP i finales është shpallur Drilon Hajrizi, çmim të cilin ia ka dorëzuar Sekretarja e Përgjithshme e basketbollit të Kosovës, Elvira Dushku. Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu i ka dorëzuar Kupën, kapitenit të Trepçës, Valdrin Haxhiu.



Bashkimi fiton për herë të tretë radhazi

Bashkimi ka triumfuar sërish në Kupën e Kosovës për herë të tretë radhazi. Skuadra prizrenase në finale fitoi ndaj Prishtinës me rezultat 56:75. MVP e finales është shpallur Arbnore Përçuku, çmim të cilin ia ka ndarë Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku.

Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës, Arben Fetahu i ka ndarë Kupën, kapitenes së Bashkimit, Aulona Muhadri.

Bora fiton Kupën e Ligës së Parë

Bora ka triumfuar në Kupën e Ligës së Parë. Prishtinasit në finale kanë shënuar fitore ndaj New Basket me rezultat 91:72. MVP i Kupës së Ligës së Parë është shpallur Dion Haxhosaj, çmim të cilin ia ka ndarë Fetahu, ashtu si Kupën, Daxhosajt për triumfin në Ligën e Parë.



Vashat e Kosovës përballë Maltës e Qipros

Më 6 shkurt në Munihi të Gjermanisë është hedhur shorti për FIBA Kampionatin Evropian, Shtetet e Vogla, si dhe grupmoshat e reja. Për herë të parë në vendin tonë do të mbahet FIBA Kampionati Evropian për Shtetet e Vogla në konkurrencën e femrave.



Vashat Dardane ndodhen në Grupin A, ku do të ndeshen me Qipron dhe Maltën. Ky Kampionat mbahet në kryeqytetin e Kosovës nga 25 deri më 30 qershor 2024. Ndërkohë, Kosova U20 te meshkujt që garojnë në Divizionin B, do të jetë në Grupin C, së bashku me Suedinë, Hungarinë, Armeninë, Ukrainën dhe Moldavinë. Kosova gjatë verës do të organizojë edhe FIBA Kampionatin Evropian, U18 te femrat, Divizioni C. Edhe vashat e reja të Kosovës do të ndeshen me Qipron dhe Maltën.

Në konkurrencën e meshkujve U18, Kosova është në Grupin B, së bashku me Estoninë, Poloninë, Islandën, Hungarinë dhe Zvicrën. Kosova U16 te femrat është caktuar në grup me Sllovakinë, Ukrainën, Islandën dhe Turqinë. Në konkurrencën e meshkujve, Dardanët e rinj janë në grup me San Marinon, Gjibraltarin dhe Armeninë.



Fillon Programi “Sport në Shkollë”

Më 26 janar zyrtarisht është lansuar Programi “Sport në Shkollë”. Lansimi është bërë në ShFMU “Xheladin Rekaliu”, Podujevë. “Sporti në Shkollë”, është hartuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Federatën e Sportit Shkollor të Kosovës. Pjesë e këtij programi është Federata e Basketbollit e Kosovës me basketbollin 3x3.

Më pas FBK së bashku me FSSHK-në kanë vizituar shkollat ku po zhvillohet Programi, derisa ju kanë bashkuar edhe basketbollistë/e të Kosovës.

SAFEGUARDING FUTURE

WORK PACKAGES

Work Package No	Work Package Name	Lead Beneficiary	Start Month	End Month	Deliverables
WP 1	Project Management and Coordination	KOS BF	1	18	D1.1 - Project Management and Coordination Framework D1.2 - Internal Interim Progress Report D1.3 - Internal Final Progress Report
WP 2	Needs Assessment	KOF BF	2	5	D2.1 - Research Methodology Document D2.2 - Needs Assessment Report
WP 3	Development of Safeguarding Policies, Procedures and Guidelines	KOS BF	6	10	D3.1 - Tailored safeguarding policies, procedures and guidelines D3.2 - Stakeholder Consultation Report
WP 4	Communication and Adoption of Policies	KOS BF	11	14	D4.1 - Communication strategy D4.2 - Training Materials D4.3 - Policy adoption report
WP 5	Monitoring and Evaluation	KOS BF	1	18	D5.1 - Monitoring and Evaluation Plan D5.2 - Evaluation Report D5.3 - Revised Safeguarding Policies



Lansohet nga FBK, Projekti shumë i rëndësishëm Safeguarding the Future

Në një konferencë për media nga Federata e Basketbollit e Kosovës është lansuar (27 janar) edhe zyrtarisht projekti shumë i rëndësishëm Safeguarding dhe Future, i fituar në kuadër të programeve të Erasmus +. Në konferencë është folur për rëndësinë e këtij projekti dhe implementimin e tij. Qëllimi kryesor i projektit është të ndërmarrë veprime për të mbrojtur njerëzit nga çdo lloj abuzimi në basketboll. Po ashtu është organizuar Punëtorja e Parë në mes përfaqësuesve të Federatave Nacionale që janë pjesë e projektit, ku janë shpalosur të gjitha Paketat e Punës në kuadër të këtij projekti.



Boston Celtics (Lidhja e Prizrenit) fiton edicionin e dytë të JR NBA Kosova

Ka përfunduar edicioni i dytë i JR NBA Kosovës, një projekt për zhvillimin e gjeneratave të reja. Ky ishte edicioni i dytë i kësaj gare, ku kanë marrë pjesë 30 shkolla fillore (11-13 vjeç) nga e gjithë Kosova dhe më pas ishin

ndarë në dy Konferenca (Lindore e Perëndimore) dhe gjashtë Divizione. Pas garave që u zhvilluan në qytetet e mëdha të Kosovës, më 9 janar u zhvillua Final 4 i kësaj gare në Prishtinë. Finalja u zhvillua mes Boston-it dhe Portland-it, ku Boston Celtics ishte më i mirë dhe fitoi 54:22. Ky është një projekt madhor nga Federata e Sportit të Republikës së Kosovës dhe Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK).



Nënshkruhet marrëveshja FBK dhe Albi Mall

Është nënshkruar marrëveshja (më 29 janar) zyrtarisht ndërmjet Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) dhe kompanisë Albi Mall. FBK dhe Albi Mall kanë nënshkruar marrëveshjen për 4 vjet, ku të dyja palët janë shprehur të kënaqur për arritjen e marrëveshjes dhe bashkëpunimin e ngushtë, që do të kenë për të ardhmen.

Në konferencën për media, Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku është shprehur shumë e lumtur për arritjen e marrëveshjes. Edhe Albi Humolli, përfaqësues i Albi Mall ishte shumë i lumtur për marrëveshjen dhe bashkëpunimin me Federatën e Basketbollit të Kosovës.

Nënshkruhet Memorandumi me MKRS-në

Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) (më 8 shkurt) ka nënshkruar Memorandumin me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS). Marrëveshjen e kanë nënshkruar Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Fetahu dhe Zëvendësministrja e MKRS, Daulina Osmani.

FBK dhe MKRS kanë bashkëpunim të ngushtë dhe ky bashkëpunim do të thellohet edhe më shumë në vitin 2024. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit gjithmonë ka qenë përkrahëse e organizimeve të FBK-së, e për këtë Federata e Basketbollit e Kosovës do të jetë gjithmonë mirënjohëse.



Aktivitetet e FBK-së

Ndërroi jetë Nexhdet Hoxha, ish-gjyqtar dhe ish-vëzhgues në basketboll

Prishtina e fiton Kupën e Veteranëve në Mitrovicë

Grapeland fiton Kupën e Ligës së Dytë

Malvina Haziri dhe Yll Kastrati për zgjidhen si Shpresa Olimpike

Artina Hasani diplomon në Programin S2ABC Project

Mbahet FIBA Scod Klinika e Gjyqtarëve

Elvira Dushku në Tryezën e Pestë të Sportit, flet për organizimin e garave ndërkombëtare në Kosovë

Adriatik Rraci dhe Artina Hasani, pjesëmarrës në shortin dhe Workshopin në Muni

Adriatik Rraci në Workshopin për JR NBA në Paris

Dushku flet për Planin Strategjik të FBK-së për pjesëmarrësit e Programit S2ABC Project

Vlora Braha në krye të detyrës në ndeshjen Italia-Turqia



FALEMINDERIT



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË
DHE SPORTIT



TEB

ART
MOTION



albi MALL



M automita®

RUGOVE